



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:053035

Datë: 19.02.2021

Numri i dokumentit: 01523977

PKR.nr. 206/2014

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN –Departamenti i Krimeve te Rënda, në trup gjykues të përbërë prej gjyqtarit Aziz Shaqiri – kryetar i trupit gjykues, Veli Kryeziu dhe Behar Ymeri anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit V. Sh. nga fshati ..., Komuna e Vitisë, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale mashtrimi në votime nga neni 180 të Kodit Penal të Kosovës UNMIK /RREG/2003/25 të datës 6 korrik 2003 (në tekstin e mëtutjeshëm KPK-s) sipas aktakuzës së Prokurorisë Komunale në Gjilan tani të transformuar në Prokurori Themelore – Departamenti i Krimeve të Rënda PP.nr.1802/2011 të datës 16.09 të vitit 2011, të cilën e përfaqësoj prokurori i shtetit Arben Ismajli gjatë seancës së shqyrtimit fillestar dhe publik më datën 19 shkurt të vitit 2021, nxjerr kurse kryetari i trupit gjykues komunikoi këtë,

A K T G J Y K I M

I. Ndaj të akuzuarit V. SH. nga i ati .. dhe e ëma Z., me mbiemër të vajzërisë ..., i lindur më datën ... në ..., tani me vendbanim në fshatin ..., komuna e Vitisë, ka të kryer shkollën e mesme, ..., me gjendje të mesme ekonomike, i pamartuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, kinse i padënuar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale kundër tij,

në kuptim të nenit 91 paragrafi 6 lidhur me nenin 90 paragrafi 1 nënparagrafi 4 të Kodit Penal të Kosovës, për shkak të **parashkrimit absolut të ndjekjes penale**,

Refuzohet akuzat

Se më datën 12 dhjetor të vitit 2010, në fshatin ..., Komuna e Vitisë, pikërisht në Shkollën fillore “ ... “, në vendvotimin ... gjatë zgjedhjeve Parlamentare të Republikës së Kosovës, i akuzuari i parë ... në cilësinë e kryesuesit të vendvotimit, kurse të pandehurit e tjerë ndër ta edhe ... në cilësinë e anëtarëve të komisionit votues, në formularin e regjistrimit të të dhënave dhe rezultateve të votimeve, kanë falsifikuar rezultatet e zgjedhjeve për deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që gjatë dhe pas numërimit të votave kanë falsifikuar votat e subjekteve politike dhe të kandidatëve të tyre duke manipuluar kështu me 774 vota, respektivisht duke ua shtuar 565 vota disa subjekteve tjera politike, respektivisht kandidatëve të tyre, gjë që është vërtetuar gjatë rinumërimit të votave nga ana e KQZ-së në Prishtinë dhe në

këtë mënyrë kanë ndikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë në rezultatet e votimit duke favorizuar kështu subjektet dhe kandidatët e tyre të preferuar dhe duke dëmtuar subjektet e tjera politike dhe kandidatët e tyre,
-me çka kishte me kryer veprën penale **mashtimi në votime** nga neni 180 të KPK-s.

II. Shpenzimet e procedurës penale lidhur me këtë lëndë penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës në Prishtinë.

A r s y e t i m

Prokuroria Komunale në Gjilan tani e transformuar në Prokurori Themelore – Departamenti i Krimeve të Përgjithshme më datën 16.09 të vitit 2011 ka ngritur aktakuzë kundër shtatë të akuzuarve ndër të tjera edhe ndaj të akuzuarit ..., për shkak të dyshimit të bazuar se më datën **12 dhjetor të vitit 2010** sipas përshkrimit faktik në aktakuzën lëndore kanë kryer veprën penale mashtimi në votime nga neni 180 të KPK-s, për të cilën parashihet dënimi me burgim deri në pesë vite.

Gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës pasiqë me ftesë të rregullt nuk ka arritur që ta siguroj praninë e të pandehurit ... në seancën për konfirmimin e aktakuzës më datën 11 nëntor të vitit 2011 ka konfirmuar aktakuzën lëndore ndaj gjashtë të pandehurve tjerë ndërsa me urdhresën pasuese ka siguruar të njëjtin në seancën e konfirmimit të aktakuzës të mbajtur më 22.11 të vitit 2011, duke e konfirmuar aktakuzën lëndore edhe përkitazi me këtë të pandehur.

Sipas Procesverbalit për konfirmimin e aktakuzës të datës 22.11 të vitit 2011 i akuzuari ..ndër të tjera ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e komunikuara dhe se nuk dëshiron të angazhohet mbrojtës profesional dhe se nuk e pranon fajlësinë për veprën penale e cila i vihet në ngarkesë duke i propozuar gjykatës që ta hudh aktakuzën duke mos e konfirmuar të njëjtin.

Gjyqtarja për konfirmim me aktvendimin KA.nr. 82/2011 të datës 22.11 2011 ka konfirmuar aktakuzën lëndore të orfnganit të ndjekjes penale edhe përkitazi me të akuzuarin V. Sh..

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Viti me aktvendim të datës 11.03 të vitit 2013 është shpallur inkompetente sipas dispozitës nga neni 22 paragrafi 1 pika 1.65 zë Kodit të përkohshëm të Procedurës Penale për gjykimin e kësaj lënde penale, duke ia transferuar të njëjtin Gjykatës Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, me arsyetim se vepra penale e mashtimit në votime nga neni 180 të KPK-s UNMIK /RREG/2003/25 kësaj dispozite ligjore kjo vepër penale kualifikohet si krim të rëndë, e kjo dispozitë procedurale është konfirmuar edhe me nenin 19 paragrafi 1. të Ligjit për Gjykatat si ligj special që ndër të tjera rregullon edhe kompetencën lëndore të gjykatave në sistemin gjyqësor të vendit.

Sipas procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të përpiluar nga trupi gjykues të datës 12.08 2014 me aktvendim procedural është shtyer shqyrtimi gjyqësor për datën 30.09 2014 përkatësisht për datën 16.10 2014 ora 9,00 duke urdhëruar që ndaj të akuzuarit V. Sh. të lëshohet urdhërarrest. Në seancën e radhës të datës 16.10 2014 (ku edhe është bërë përmirësimi i datës dhe muajit me dorë të lirë nga 12.08 në 16.10 duke mbetur viti 2014 është konstatuar në procesverbal se gjykata nuk është njoftuar për arsyet e mosekzekutimit të urdhërarrestit ndj të pandehurit V. dhe se në atë senacë nuk ka prezentuar i akuzuari V. Sh.. Sipas këtij procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor ku trupin gjykues e ka kryesuar gjyqtari Afrim Shala është konstatuar se me aktvendim është veçuar procedura penale ndaj të akuzuarit V. Sh. duke u urdhëruar lëshimi i

urdhërrarretit ndaj tij, ndërsa ndaj gjashtë të akuzuarve tjerë ka vazhduar procedura e shqyrtimit gjyqësor.

Në njoftimin me shkrim të Policisë së Kosovës – Stacioni Policor në Viti pa datë oficeri policor me e ka njoftuar gjykatën se prindi i të akuzuarit V.. e ka njoftuar policinë se djali i tij gjendet në studime në Prishtinë. Tek më datën 10.09 të vitit 2015 kryetari i trupit gjykues Afrim Shala ka lëshuar urdhër për lëshimin e letërrreshtimit ndaj të akuzuarit V. Sh. duke urdhëruar ekzekutimin e këtij urdhëri nga Policia e Kosovës. Sipas kërkesës për informata të kësaj gjykate drejtuar Policisë së Kosovës – Stacioni Policor në Gjilan më datën 03 nëntor 2016 në shtojcë të saj gjendet tabela me emrat dhe të dhënat tjera për 36 të pandehur ndër të tjera edhe ndaj të akuzuarit V. Sh. (vlen të theksohet se në të gjitha këto shkresore emri i babait të këtij të akuzuari është shënuar R. kurse në procesverbalin për konfirmimin e aktakuzës të datës 22.11 2011 emri i babait të tij është shënuar I. e që dallon edhe nga aktakuza edhe nga aktet tjera bile edhe nga urdhresa për lëshimin e letërrreshtimit në të cila është shënuar emri i babait të këtij të akuzuari – si R..).

Në përgjigjen me shkrim në formë të njoftimit të Stacionit Policor në Gjilan të datës 07.11 2016 nën numrin rreshtor 37 është shënuar PKR.nr. 206/14 V.. R.. Sh.. ... Viti, fshati ... e ka aktive lëndën vepra 180 KPK.

Si kryetar i trupit gjykues lënda penale në fjalë konstatohet se i është dorëzuar gjyqtarit Aziz Shaqiri pas shkuar së gjyqtarit Afrim Shala në Gjykatën e Apelit në Prishtinë edhe atë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2018, duke mos ndërmarr asnjë veprim procedural, pasi që ka konstatuar se ndaj të pandehurit në fjalë është dhënë urdhër për lëshimin e letërrreshtimit me numër dhe datë të lartcekur.

Gjykata ka konstatuar se gjer në ditën e vendosjes nuk është ekzekutuar letërrreshtimi i urdhëruar nga kjo gjykatë nga ana e Policisë së Kosovës dhe se gjykata nuk ka qenë e njotuar gjer më sot se ky i akuzuar ku gjendet përkatësisht se ku e ka vendqëndrimin e tij brenda Republikës së Kosovës ose jashtë saj.

Gjykata ka vërtetuar se më datën 16.09 2011 organi i ndjekjes penale ka ngrit aktakuzën lëndore për shkak të dyshimit të bazuar ndër të tjera që edhe i akuzuari V. Sh. si anëtarë i komisionit votues më datën **12 dhjetor të vitit 2010** në zgjedhjet Parlamentare të Republikës së Kosovës sipas përshtimit faktik të akuzës së bashku me gjashtë të akuzuarit të tjerë kishte falsifikuar rezultatet e zgjedhjeve, duke kryer veprën penale mashtimi në votime nga neni 180 të KPK-s për të cilën parashihet dënimi me burgim deri në pesë vjet.

Sipas Kodit Penal të Kosovës në kohën kur edhe dyshohet me bazë se ky i akuzuar ka kryer veprën penale lëndore, edhe atë me nenin 90 paragrafi 1 nënparagrafi 4 të këtij Kodi parashihet se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse **kanë kaluar pesë vjet nga kryerja e veprës së dënueshme** (të kryer më 12 dhjetor 2010) **me më shumë se tri vjet por jo edhe me më shumë se pesë vjet por deri në pesë vjet** – si afat i parashkrimit relativ të ndjekjes penale.

Mirëpo sipas nenit 191 paragrafi 6 të të njëjtit Kod parashihet se : ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit relativ (**ndalesa absolute mbi ndjekjen penale**). E dyfishi i parashkrimit relativ prej pesë viteve duke filluar nga data **12 dhjetor 2010 është dhjetë vjet dhe i njëjti, ka kaluar më datën 13 dhjetor të vitit 2020.**

Andaj edhe për arsye të lartcekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në kuptim të nenit 363 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPP-s.

Në kuptim të nenit 454 paragrafi 1 të KPP-s pasiqë është refuzuar akuza lëndore për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të bien në barrë të mjeteve buxhetore të KGJRK në Prishtinë.

Në kuptim të nenit 537 paragrafi 1 të KPP-s parashihet : organi i cili ka urdhruar letërrreshtimin, e tërheq atë , kur të kalon afati i parashkrimit të ndjekjes penale (e në këtë rast ka kaluar afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale) Ndërsa sipas paragrafit 2 të të njëjtit nen parashihet se urdhri për tërheqjen e letërrreshtimit duhet t'i dërgohet autoritetit kompetent i cili duhet të siguroj anulimin e menjëhershëm të tyre. Andaj edhe gjykata pasi që konstaon se janë plotësuar kushtet ligjore do të lëshoj urdhër për tërheqjen e letërrreshtimit ndaj të akuzuarit V. Sh., për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Vërejtje e gjykatës : Pasiqë në kuptim të nenit 478 paragrafi 2 të KPP-s parashihet se të pandehurit i cili nuk ka mbrojtës i dërgohet personalisht aktakuza, **aktgjykimi** dhe vendimet tjera për të cilat afati i ankesës fillon nga dita e dorëzimit ... Mirëpo, duke e interpretuar në mënyrë ekstensive dispozitën ligjore nga paragrafi 3 të të njëjtit nen, me vet faktin që në rastin konkret **nuk kemi të bëjmë me aktgjykimi me të cilin është shqiptuar dënimi me burgim dhe i njëjti nuk mund eventualisht t'i dërgohet në adresën e mëparshme të të pandehurit**, gjykata **nuk ka detyrim ligjor që të caktoj mbrojtës profesional për të pandehurin në fjalë**, kështu që nëse eventualisht nuk mund t'ia dorëzoj të pandehurit në fjalë aktgjykimin lëndor në adresën e mëparshme të tij – meqë nuk ka njohuri për vendqëndrimin aktual dhe adresën e re të tij, në kuptim të kësaj dispozite **aktgjykimin do të vihet – ngjitet në stendën e kësaj gjykate dhe pas tetë ditëve nga dita e vënies në stendë dorëzimi i aktgjykimit lëndor do të konsiderohet ligjërishit valid sipas kësaj dispozite ligjore procedurale.**

Për arsyet e lartcekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.206 /2014, më datën 19 shkurt të vitit 2021**

Sekretarja juridike,
Kadrije Zymberi

Kryetari i trupit gjykues,
Aziz Shaqiri

Udhëzim për mjetin juridik : Kundër këtij aktgjykimi mund të praqitet ankesë në Gjykatën e Apelit – Departamenti i Krimeve të Rënda në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.